



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0084190-1/23 dt. 30.11.2023
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e 26-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 30.11.2023 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Hamdi Hasani, Mentor Vinarci, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Egzon Hamza, Nafije Rexha, Faruk Mujka, Kushtrim Zeneli, Jeton Zeneli, Armend Begu, Ekrem Sadiku, Shkurta Shosholli Musa, Erseka Barani, Xhylljeta Imeri, Sevdaim Uka, Gazmend Asllani, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri, Ardita Aliu dhe Gjergj Beka

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Lavdim Zeneli, Hysen Muzliukaj, Naser Muja, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi dhe Flutura Beka Kamberaj

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës ka thirrur mbledhjen e 26-të të rregullt të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Faruk Mujka: I nderuar Kryetar, Nënkryetar, Kryesuese, drejtorë, kolegë të asamblesë, me 3 shkurt të këtij viti kemi pasur një kërkesë, e cila atëherë ka qenë aktuale, bëhet fjalë për faljen e njëqind eurove tatim në pronë për të gjithë qytetarët e Mitrovicës, Kryetari pat thënë që është i gatshëm të dalë me një propozim pas vendimit Gjykatës, domethënë kjo ka dalë, ka marrë përfundim pozitiv në Gjykatën Kushtetuese dhe tash është në kuvendet komunale me marrë një vendim të tillë për qytetarë ose jo, unë e di gjendjen në të cilën është Komuna e Mitrovicës, por ma merr mendja se është e drejtë e qytetare me bë një kërkesë të tillë. E dimë që herën e parë ka pas ankesa për rritjen e normës për tatim në pronë, nëse është dyfishuar vlera e tatimit, andaj, në qoftë se ka pas dyfishim të të hyrave nga kjo vijë buxhetore, ma merr mendja që nuk kish dashur me qenë problem edhe falja e njëqind eurove për tatim në pronë për qytetarët. Mendoj se me këtë tregojmë vullnetin dhe dëshirën

për me ndihmuar qytetarët. E dimë që me këtë vendim ata të cilët e kanë paguar ju hjeket pagesa në vitin e ardhshëm, prandaj e shoh të arsyeshme që këtë çështje prapë me risjellë në Kuvend, ndërsa Kuvendi me marrë vendimin përfundimtar.

Kryetari Bedri Hamza: Është mirë secili organ, nivel qendror apo lokal, kur të merr vendim dhe nëse do të bëj nderë, të bëj me paret e veta. Edhe popullizmat me i bërë në ngarkesë të atij që e merr vendimin, se s'ka kurrfarë logjike ekonomike me marrë vendim për me qenë barrë e një organizate tjetër buxhetore. Prandaj, kish me pas minimumin e minimumit të korrektësisë ata që e kanë sponsorizuar këtë ligj, të gjitha ndikimet negative të cilat komunat mund t'i kenë si rezultat i këtij neni specifik, me u rimbursuar prej nivelit qendror. Kjo nuk do të ndodhë. Çka është me rëndësi, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka dalë. Gjykata Kushtetuese nuk e ka kontestuar ligjin, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka dalë në një kohë ku për këtë seancë nuk ka qenë e mundshme që kjo pikë të përgatitet dhe të propozohet, sigurisht se ne kemi konsideratë edhe kem ndjeshmëri edhe për gjendjen socio-ekonomike të të gjithë tatimpaguesve, kjo është e njëhershme, është për vitin aktual dhe nuk përsëritet në vitet vijuese. Nuk ia zgjidh problemin një tatimpaguesi, vetëm se ia lehtëson. Mendoj që ne do ta trajtojmë këtë me kujdes, do ta shikojmë se cili është edhe ndikimi negativ në buxhet, është totalisht e papranueshme edhe e paqëndrueshme që buxheti të goditet prej dy anëve edhe prej pjesës së të hyrave, edhe prej pjesës së shpenzimeve dhe faktikisht domethënë vijmë në një situatë që komunat të jenë organizata buxhetore të falimentuara, me përgjegjësi po them, të falimentuara.

Tamam kemi ardhë në fazën finale të përmbylljes së obligimeve nga kontrata kolektive për shujta dhe çështje tjera, tash janë duke u zhvilluar procese gjyqësore dhe janë duke ardhur vendime me shuma aq të larta që për komunat kanë me qenë të papërballueshme, kanë me u rreziku shumica e komunave të Kosovës që realisht edhe projektet që i kanë të filluara e të kontraktuara mos me mujtë me i përfundua edhe me i pagu. Prandaj z. Mujka, e çmoi çështjen që ju e ngritët, megjithatë, ne duhet me e trajtuar dhe për këtë seancë nuk ka pas mundësi që të procedohet në mënyrë të rregullt, se ka dalë vendimi më vonë, në një nga seancat e radhës, varësisht prej kalkulimeve që do dalin do të jemi shumë të kujdesshëm, po edhe një çështje tjetër duhet me pa me ligj, baza e tatimit në pronë nuk është në diskrecion të komunës për me ndryshuar, por norma e tatimit në pronë është në diskrecion të komunës dhe nëse vlerësohet që është barrë e lartë për një tatimpagues në komunën e Mitrovicës, ne mund ta trajtojmë normën dhe normalisht nëse norma aktualisht është 0,15 minimumi, ne bashkërisht këtu me juve, në bazë të kalkulimeve do të vijmë me propozime që e njëjta ngelet 0,15, bëhet 0,12, 0,10 dhe të jetë një shumë e përballueshme për qytetarët e Mitrovicës. Prandaj, unë duke vlerësuar këtë që ju e ngritët, ne kemi diskutuar edhe në të kaluarën, po për këtë seancë vendimi ka dalë me vonësë dhe ne nuk kemi pasur mundësi të përgatitemi sepse seanca ka qenë e thirrur dhe presim që nëse mbahet seancë brenda këtij viti në afatin ligjor.

Faruk Mujka: Po, Kryetar, është e drejtë që vendimet e nivelit qendror t'i bartin komunat, nuk është hera e parë, është hera e tretë e katërt, ka qenë me ngritjen e pagave të Shërbyesve Civil 2015/16, i ka dhënë barrë pushtetit lokal kur pagat në vitin 2015 janë ngritë, e kemi pas çështjen e kontratave kolektive, ka qenë vendim i Qeverisë, por është zbatuar nga komunat, edhe kjo siç thatë e mira e saj që është e njëhershme, ndërsa rritja e tatimit juve ju siguron edhe për vitet e ardhshme ngritjen e të hyrave nga kjo vijë buxhetore edhe çka është më e rëndësishmja ju thatë që mundet me u diskutuar në mbledhjen e radhës, por ju dini që afati i fundit për me u diskutua kjo çështje është 8 dhjetori, deri më 8 dhjetor kuvendet komunale duhet me marrë vendim, ose mbledhje e rregullt ose mbledhje e jashtëzakonshme. Kështu që, z. Kryetar, në qoftë se doni me marrë vendim, është sot, në qoftë se doni mos me marrë vendim, e me thanë madje kemi kaluar afatet ligjore, mundeni edhe me lënë për një mbledhje tjetër, por unë po e mendoj që është mirë me sjellë një vendim ku komuna e Mitrovicës ua falë borxhin apo ua falë njëqind euro nga tatimi në pronë qytetarëve të Mitrovicës.

Kryetari Bedri Hamza: Po, afati ligjor ashtu është i specifikuar, keni drejtë, mirëpo realisht vendimi është dalë vonë dhe për këtë mbledhje unë jam i sigurt që pa një kalkulim të mirëfilltë, pa

një procedurë në të cilën duhet me kaluar vendimet me peshë të tilla nuk është mirë me u marrë. Prandaj, ne do të shikojmë që t'ia lehtësojmë barrën jo vetëm për një herë, se dallimi është a po flasim njëhershëm apo flasim në vazhdim. Unë mendoj që më e pranueshme edhe më e përballueshme për Komunën është me bërë analizë të mirëfilltë të normës tatimore, minimumi ka qenë 0,15 tash ligji ta ka dhënë mundësinë që me shku nën 0,15 dhe ne do ta shikojmë normën tatimore dhe përmes normës tatimore ne qytetarëve që paguajnë tatim pronë, ju ndihmojmë jo vetëm për vitin aktual, që pastaj e ndikon edhe në vitin vijues. Realisht komuna, shteti mbahet prej tatimeve dhe nuk besoj që ka mundësi në një vend që të ketë projekte, të zhvillohen projekte pa pas të hyra. Andaj të hyrat nga tatimi jonë janë të hyrat kryesore të cilat i administrojnë, i mbledh edhe i përdor secila komunë. Prandaj, mendoj që përmes normës tatimore ne mund ta rregullojmë lartësinë e tatimit të pronë edhe nuk do të jetë veç për vitin 2023, qysh e shpjeguam më herët dhe me ndikim në vitin 2024, po do të jetë në vazhdimësi.

Kryesuesja Vesa Broja: E lus Kryetarin, në këtë rast edhe ekzekutivin që përnjëmend me ba një analizë të kësaj çështje edhe nëse dalim me një përfundim që po dojna me i falë edhe duhet me i falë deri në njëqind euro, kemi mundësi me e mbajt një seancë të jashtëzakonshme edhe kemi mundësi tjera në afat të paraparë ligjor. Propozimi konkret është: të përfshihet si pikë e rendit të ditës, falja e tatimit në pronë deri në njëqind euro; mandej vazhdojmë me votim të propozimeve për rend dite.

Gazmend Asllani: I nderuar Kryetar, Nënkryetar, të nderuar të pranishëm, unë në seancën e kaluar kam kërkuar që DKRS të na sjellë një raport të detajuar për Sallën e sportit Minatori, për tribinën VIP që e kanë rregulluar, edhe për kamerat e vendosura. Jo që s'na ka pru raport të detajuar, por vetëm një përgjigje dje mbas dite dhe ajo nuk është ajo që e kam kërkuar. Në përgjigje thotë që ne si Drejtori nuk kemi pas mundësi me realizuar këtë projekt. Në rregull pajtohem. Po ka thënë që klubi basketbollistik Trepça ka ofruar donacion, edhe kjo është në rregull, po donacioni i ka do procedura të veta, prandaj pyes se a janë përfillë ato procedura? Unë kam kërkuar nga ju të na sillni një raport të detajuar, a ke marrë leje prej Drejtorisë së Urbanizmit për me ndërtuar atë tribinë? A ke hapë tenderë për me realizuar at projekt? A e kanë konstatuar ekspertët e asaj fushe që ka siguri, se çështjen e kam ngritë për shkaqe të sigurisë, e dini edhe ju këtu, edhe të gjitha procedurat që janë a janë respektuar? Ju nuk keni ofruar kurrfarë përgjigje, veç donacione na ka ofru klubi edhe klubi e ka realizuar këtë projekt. Qysh ka drejtë klubi me realizuar në objekt të komunës diçka të tillë, a po më tregon qysh ka drejtë ai është shfrytëzues i atij objekti.

Vesa Broja: nëse jeni dakord, kjo çështje të diskutohet te pika pyetje përgjigje, nëse ka pyetje specifike e konkrete.

Kryetari Bedri Hamza: Faleminderit, z. Asllani! I ke ngritë pyetjet specifike, e ke marrë një përgjigje. Nëse përgjigja është jo e plotë në raport me atë çka ke kërkuar, unë po i kërkoj drejtorisë përkatëse që në të gjitha pyetjet tua specifike, një për një me të dhënë përgjigje.

Gazmend Asllani. Te pyetja e dytë, që kam thënë për vendosjen e kamerave, ti ke thënë që është e nevojshme. Unë pajtohem që është e nevojshme, por jo me menaxhu klubi, edhe te kjo e ke cekë që ke thënë është donacion prej klubi. Edhe mbi të gjitha shtrohet tash pyetja: klubi paska mundësi me jep donacione, kur ju si drejtori e keni subvencionua klubin me mbi pesëdhjetë mijë euro, pse me subvencionu klubin kur ai paska mundësi me u jep donacione juve si drejtori. Më mirë është këtë mjete me i shpenzua në një fushë sportive dikund, në ndonjë lagje, se sa klubit që paska mundësi me të japë donacione.

Kryetari Bedri Hamza? Sa i përket subvencioneve, janë subvencionua klubet e Mitrovicës, dhe mendoj që është mirë, edhe kjo është përkrahë edhe prej Asamblesë, pa dallime politike. Kanë qenë standard dhe kanë qenë kriteret. Do klube janë në gjendje më të mirë financiare kjo duhet me na gëzu. Do klube janë në gjendje më të dobët financiare, do kanë më shumë sponsorë, do kanë më pak sponsorë. Dihet që në Mitrovicë basketbolli është prej sporteve që është më popullore dhe më i përkrahur. Sponsorët japin donacione dhe investojnë se ata kanë edhe marketing aty ku ka më shumë

shikues edhe shikueshmëri, prandaj besoj që kjo pjesa e subvencioneve është çështje e përfunduar, është me procedura edhe raportohet në raport financiar secili klub sa i ka marrë, qysh i ka marrë, unë kërkoj që të jetë përgjigje e plotë specifikisht në secilën pyetje të ngritur. Domethënë nëse përgjigja është e paplotë, sipas kërkesave të juaja dhe ka nevojë që të ketë sqarime shtesë, unë kërkoj që të jepen të gjitha sqarimet në pyetjet edhe dilemat e ngritura.

Gazmend Asllani: Edhe unë pajtohem me ty, që asnjëherë më parë nuk kanë jep më shumë subvencione se kësaj here që je ti Kryetar. E kam edhe një pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit: a kanë kërku leje për ndërtimin e asaj tribine drejtoria përkatëse apo edhe klubi, që e ka ndërtu klubi, që po thotë drejtoresha në përgjigje? Edhe tjetra, drejtoreshë a e merr ti përgjegjësinë nëse ndodhë diçka që s'ka siguri ajo tribinë?

Faruk Mujka: Tash u hap kjo temë edhe është me interes për të gjithë. Ajo palestër sportive është pronë e komunës, edhe për secilin investim, ndryshim duhet me marrë leje prej komunës dhe drejtorisë përgjegjëse. I shërben të gjithë komunitetit sportiv aty, jo një klubi. Mirë është kur është një klub i fortë, ju ndihmon edhe klubeve të tjera. Domethënë se ato investime kanë me iu ndihmuar edhe klubeve tjera. Normal në këtë rast për momentin përfitues kryesor është basketbolli, sepse është më i shikueshmi. Mirëpo, pa marrë parasysh për çfarëdo donacioni, duhet me pasë një marrëveshje. Atë marrëveshje duhet me bërë në Komunën e Mitrovicës dhe duhet me plotësuar të gjitha standardet. Një leje ndërtimore duhet me u marrë, edhe pse është donacion edhe pse është për të mirë, mirëpo duhet me marrë një letër mbështetëse prej Drejtorisë së Urbanizmit, duhet të zbatohen procedurat.

Valdete Idrizi: E nderuara Kryesuese, Kryetar, asamblistë, qysh ju kam thënë edhe në përgjigjen në e-mail po ju falënderoj për pyetjen, se është në interes të publikut, jo veç komunitetit sportiv, po të gjithëve. Unë ju kam thënë edhe në përgjigje që kurr gjë, ama kurr gjë, asnjë hap, asnjë dritë, asnjë top, as kurr gjë nuk bëhet pa marrëveshje dhe pa pëlqim paraprak me shkrim nga DKRS-ja. Ju kam shkruar dhe ju thashë që jeni shumë të mirëseardhur edhe në drejtori sidomos pasi që ju vini prej komunitetit sportiv, me ardhë edhe me sugjerime dhe me kritika mos me pritë deri në fund përgjigjen, po mundeni me ardhë në çdo kohë. Edhe ju kam thënë, bash me mirësjellje, pa pikë cinizmi, sepse vini prej atij komuniteti edhe mundeni me na jep sugjerime. Ju kam thënë se jam shumë e vetëdijshme se pronë e kujt është edhe nuk është veç e klubeve të basketbollit, por edhe klubeve tjera, edhe klubeve të hendbollit. I kam pasë me shkrim disa kërkesa shtesë për disa hapësira, nuk subvencionohet veç klubi i basketbollit Trepça, se po e shoh që ju e keni pikërisht me klubin e basketbollit Trepça, mendoj që nuk është etike, nuk është në rregull ju që keni pakënaqësitë me klubin Trepça që nëpërmjet drejtorisë tonë këtu edhe në Kuvend me i shprehë. Unë edhe një herë po e them qysh e kam shkruar, e di se je një sportist, kam me ju dërguar të gjitha marrëveshjet me shkrim, kam me ju dërguar të gjitha ato dokumente që ju kam thënë. Ju kam thënë se ekziston me shkrim që ka edhe inxhinierë të statikës që e konstatojnë sigurinë dhe ai bëhet përgjegjës. Ekzistojnë dokumentet, tash gjatë pauzës hajde në zyrë e mundeni me i marrë! Përgjigjen dhe raportin e detajuar do ti dërgoj në seancën e dhjetorit kur do të raportoj si Drejtori. Ka qenë një pyetje edhe për shkallët e vendosura, po u sqaroj se këto shkallë nuk janë të palestrës sonë, me lejen tonë me shkrim ia kemi marrë hua ndërmarrjes Omnisport, vitin tjetër do ti vendosim. Kështu që ne po mundohemi me shpirt të investojmë, tash aktualisht është rregullimi i nyjeve sanitare në palestër, te pjesa e jashtme rregullimin e mureve më e vazhduar ne si drejtori. Po kur nuk i kemi parapa këto ulëse dhe interesimi është jashtëzakonisht i madh i qytetarëve edhe po dua me i falënderuar gjithë ata që po kontribuojnë. Në këtë rast nuk është veç klubi i basketbollit Trepça, po janë edhe klube tjera që po kanë mirëkuptim edhe po bashkëpunojnë me neve si drejtori, njëkohësisht po kontribuojnë edhe në kultivimin e sportit që është mision edhe i drejtorisë edhe i komunës tonë.

Gazmend Asllani: Problem me klubin nuk kam asgjë, nëse ti di diçka që kam telashe me klubin ja ku e ke mikrofonin edhe tregona. Edhe një herë po ta them me mikrofon, dashninë për Trepçën s'mundet me ma heqë kurrkush, njëzet e dy vite që aty i kam lanë, a kam thyer duar a kam thyer

këmbë, pa para, me para, as ata çka janë në klub nuk munden me e dashtë ma shumë se unë Trepçën. Absolut se nuk jam kundër klubit, unë kam qef klubin me ngritë sa më lart, në nivelet më të larta. Unë kam shtruar pyetje për sigurinë e asaj tribine. Janë treqind vetë në pyetje, a ka siguri? Çka nëse ndodh diçka? Këtë e kam kërkuar, nuk kam kërkuar send kundër klubit. Duhesh me më kërkuar falje drejtoreshë për atë që e the, e the ki probleme me klubin, unë me klubin s'kam asnjë problem.

Kryetari Bedri Hamza: Sa e do Gazi Trepçën, as që duhet me u diskutuar, unë jam prej atyre që i kam shijuar lojërat e basketbollit kur ka luajtur Gazi, edhe hala e mban rekordin e pikëve. Pyetjet janë të qarta, asnjë shqetësim nuk duhet me ekzistuar kur përgjigjet janë të gatshme. Nëse dokumentet i kemi, drejtoresha e di që kur thotë i ka, i prezanton edhe mendoj që kjo çështje mbyllet. Mirëpo një diçka çka mundem me thanë të gjithë asamblistët pa dallime, janë në përkrahje, në mbështetje të klubit basketbollistik Trepça, po edhe të gjitha klubeve tjera sportive në Mitrovicë, për shkak se tekefundit Mitrovica identifikohet edhe me sportin edhe veprimtaritë tjera. Prandaj janë çështje të ngritura në mënyrë specifike, kërkojnë përgjigje, kur janë përgjigjet, kurrkush nuk ka nevojë as nuk duhet me u shqetësuar, duhet me i vendosë në dispozicion edhe mendoj që këtu përfundon kjo.

Armend Begu: Kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës, një pikë që është diskutuar edhe ma herët në seancat e mëhershme rreth uzurpimit të pronave publike, gjegjësisht trotuareve. Trotuaret në qytetin e Mitrovicës janë të uzurpuara totalisht. Pra unë mendoj që është një çështje urgjente dhe që duhet me hy si pikë e rendit të ditës, diskutimi për trotuaret të cilat janë të uzurpuara nga banorët rezidentë të banesave, të cilat ato trotuare i kanë shndërruar në parkingje të tyre private, e që qytetarët, nxënësit dhe kalimtarët nuk munden me kaluar aty dhe po detyrohen me kaluar në shiritat e trafikut. Në këtë rast po flas për telashet që janë evidente në rrugën “Pajazit Boletini” nga Gjinnazi drejt Bunarit dhe kërkoj nga drejtoria përkatëse me na e konfirmuar se a ju është dhënë leja nga drejtoria përkatëse, pra nga Drejtoria e Infatrukturës kërkoj që të na e konfirmoj se a është e vërtetë që janë legalizuar ato parkingje në trotuare apo jo pra nëse janë le të na e sjell ato kontrata që janë lejuar, pra kisha dashur që këtu të diksutojmë. Probleme të tilla ka edhe në rrugët tjera sikurse është rruga “Avni Shabani”, Rr. “Rexherp Mitrovica”, Rr. “Kemajl Ataturku”, Rr. “Besim Nuka” po edhe shumë tjera që me një fjalë ato rrugë janë një kaos i madh në qytetin tonë po për mos me zgjatë më shumë tash unë kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës sot dhe aty të diskutojmë më gjerësisht.

Kryetari Bedri Hamza: Unë e kuptoj të drejtën e secilit asamblist për me ngritë çështje dhe me propozuar pika të rendit të ditës, mirëpo, kur propozohet një pikë duhet të jetë vetëm propozim me një arsye të shkurtë e jo të hyhet në diskutim sepse unë mendoj se kështu po e hup efektin pastaj. Kjo çka ju e ngritët si shqetësim është e vërtetë se është një çështje shumë e rëndësishme për qytetin e Mitrovicës dhe qytetarët e Mitrovicës, por është një çështje që kërkon zbatim të ligjit edhe bashkëpunim me kërkesë që e bëjmë vazhdimisht edhe prej policisë. Nëse është sinjalizimi horizontal, vertikal, gjitha llojet e sinjalizimeve të mundshme, që ndalohet ndalja dhe parkingu, atëherë mendoj që këtë mundeni me ngrit si çështje, por është zor me formuluar si pikë për rend të ditës pastaj nëse është vendosur te rruga tek çerdhja e fëmijëve, sinjalizim vertikal, horizontal, ndalim në dalje dhe parkingu. Më tregoni se cila është logjika çdoherë me kërkuar përkrahje? Ju lutna, zhvendosni shitësit e druve, më tutje sepse nuk është e duhura para çerdhes së fëmijëve, motorsharrat me u dëgjuar. Prandaj, mendoj që asambleja duhet me ju drejtuar organeve kompetente, të cilat janë përgjegjëse për me zbatuar ligjin. E di që Komuna e Mitrovicës duhet me pas më shumë parkingje, se edhe për me i thënë dikujt mos u parko duhet me i thënë qe ku e ki vendin. E di që ndoshta të ardhmen duhet me e bërë parkingun edhe me pagesë, se jo me ardhë aty në rrugën publike me lënë veturën jo tonë ditën, por një javë ditë s'e lëviz. Përtej asaj na qet edhe shenja e thotë për konsumatorë. Kur ngrisim pikat, jemi pak ma preciz të ngrisim pikën nëse i plotëson kushtet, hyn në rend dite dhe trajtohet. Po nëse kalojmë në diskutim, atëherë realisht po e humbim fokusin e asaj për çka është thirrë seanca dhe për çka është thirrë mbledhja e Asamblesë.

Armend Begu: Për ata unë e propozova se me të vërtet qyteti është në kaos të madh, dhe prapë kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës dhe kërkoj që të diskutojmë për këtë pikë, dhe pika të emërohet: Lirimi i trotuarëve dhe hapësirave publike.

Ekrem Sadiku: Përshëndetje për të gjithë, propozoj për pikë të rendit të ditës të diskutojmë lidhur me mbylljen e shkollës në fshatin Selac. Në qoftë se e shihni të arsyeshme, ne këtë pikë mundemi me bartë për mbledhjen e ardhshme, mirëpo kisha kërkuar një zotim që të kemi një raport se çka ka ndodhë, a është planifikuar kjo mbyllje, çka do të ndodhë me stafin, ato që janë edhe siç e dimë, në verilindje ai ka qenë Fshati i fundit shqiptar, pas tij vijnë fshatrat serbe që janë me popullatë serbe, duhet me pasur konsideratë për këtë çështje. Mirëpo, unë po kërkoj të futet si pikë e rendit të ditës, mirëpo në qoftë se ju shihni të arsyeshme, atëherë ne e kishim me e pritë një raport lidhur me këtë çështje dhe çka do të ndodhë me shkollat tjera, cili është plani i Drejtorisë të Arsimit.

Faruk Mujka: Çështja që e ngriti Ekremi ne e dimë që është pak çështje më e ndërlikueme që me muajt me kërkua sot një raport, mirëpo është interes i përgjithshëm, nuk është veç problem i ekzekutivit, po është problem i gjithë qytetarëve. Ne e dimë që është problem me funksionu shkollat me pesë-gjashtë nxënës, mirëpo, kaherë këtu ndërlihen edhe çështjet politike, çështja e emigrimit etj. etj. Domethënë posaçërisht me fshatrat që kanë të bëjnë me disa kufij administrativ, e ka të bëjë me Selacin dhe me të tjerat, edhe me shkollat që supozohet që janë rrezik, siç është në Zabërgj, Bare, në Melenicë etj. Domethënë, cili është qëndrimi i ekzekutivit dhe cili ish dashtë të jetë qëndrimi i gjithë spektrit politik, jo veç politik, po edhe kuadrin arsimor në lidhje me këtë çështje. E normal, edhe fatin e mësimdhënësve, kur e dimë se kemi pas shkurtesa në staf, se ndoshta kemi pas nevojë na t'i mbulojmë, cila ka me qenë politika jonë dhe si synojmë me zgjidhë këtë çështje. Është pak më e komplikueme që me mujt me kry sot, po kish me qenë mirë sa më shpejt.

Kryetari Bedri Hamza: Një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, shumë e ndjeshme dhe nuk ka ndjenjë më e rëndë se sa m'i pa shkollat e mbyllura. E keqja është që kjo dukuri pritet të vazhdojë si rezultat i zvogëlimit të natalitetit dhe si rezultat i emigrimit brenda dhe jashtë Kosovës. Unë po besoj që e kam mirëkuptimin edhe tuajin, zoti Mujka edhe të zotit Sadiku, që kjo pikë edhe ky raport, kjo informatë të jetë në mbledhjen e parë, kur do që të mbajë asambleja komunale, jo vetëm për shkollën e Selacit, po për komplet shkollat në regjionin e Mitrovicës, e të cilat në një të ardhme kanë disa pikëpyetje si do të funksionojnë. Me rastin e regjistrimit të popullsisë, kur do që ndodhet, mendoj që do të del një situatë dhe një realitet jo shumë i dëshirueshëm për Mitrovicën, edhe sa i përket numrit të banorëve, edhe sa i përket numrit të nxënësve, pastaj numri i nxënësve ta cakton edhe numrin edhe normat e mësimdhënësve. Po, jemi tu bërë përpjekje që mësimdhënësit me i akomodu në shkolla tjera, me pas ata kontrata të punës, ndërsa deri në momentin e fundit kur mundim, shkollat do t'i mbajmë të hapura. Por po e vërejtë që është mirëkuptimi, është çështje jetike, shumë e rëndësishme, shumë e ndjeshme dhe në seancën e radhës, drejtoresha i ka të gjitha shënimet e nevojshme do të vijmë në Kuvend me informata dhe raport mbi gjendjen në shkolla, të cilat kanë probleme sa i përket numrin të nxënësve.

Kryesuesja Vesa Broja: Atëherë nëse je dakord Kryetar, po pajtohemi për me ardhë në seancën e ardhshme të Kuvendit si informatë nga Drejtoria e Arsimit.

Kryetari i Komunes z. Bedri Hamza: Po jam dakord.

Kryesuesja Vesa Broja: A ka diskutime tjera për rendin e ditës. Atëherë nëse jo, po vazhdojmë me votime veç e veç të pikave që janë propozuara për me qenë pjesë e rendit të ditës. Hedh në votim propozimin e z. Mujka lidhur me faljen e tatimit në pronë deri në 100 €.

Rezultati i votimit: 6 për, 15 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja Vesa Broja konstatoi se nuk futet si pikë e rendit të ditës propozimi i z. Mujka lidhur me faljen e tatimit në pronë deri në 100 €.

Kryesuesja Vesa Broja: Po vazhdojmë me propozimin tjetër, që ishte lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike, ku unë veç po du me cekë se vota ime do të jetë ajo e cila do të jetë, sepse është një çështje që na preokupon të gjithëve dhe nuk është në diçka që a keni votuar me i liruar apo mos me i liruar, u diskutua kjo pjesë dhe Kryetari e dha një përgjigje sa i përket kësaj çështje, propozimi prapë qëndron që me u fut si pikë e rendit të ditës, kështu që po shkojmë në proces të votimit. Kjo është si pikë e rendit të ditës për me qenë në debat. Kush është që të futet pikë e rendit të ditës: Lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike, pra diskutimi sa i përket kësaj çështje?

Rezultati i votimit: 8 për, 15 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja Vesa Broja konstatoi se nuk futet si pikë e rendit të ditës propozimi i z. Begu: Lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike.

Në vazhdim Kryesuesja e Kuvendit vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim-Rregullore Nr. ___/2023 Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë
3. Propozim-vendim për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024
4. Propozim-vendim për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera
5. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani"
6. Rekomandimi i Komitetit për Komunitete për zëvendësimin e anëtares së Komitetit znj. Nermina Mulliq Helshani

Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 27 për, 1 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja konstatoi se me shumicë votash është miratuar rendi i ditës.

Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin lidhur me procesverbalin nga mbledhja e 25-të të Kuvendit të Komunës.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e Kuvendit hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së 25-të.

Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Procesverbali nga mbledhja e 25-të e Kuvendit të Komunës u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja Vesa Broja para se ta hapë diskutimin lidhur me Propozim-rregulloren për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollës së mesme të lartë teknike Arkitekt Sinani në Mitrovicë theksoi se në mbledhjen e komitetit ka dalë një konkluzion, sa i përket një neni të Rregullores, të cilin e keni marrë bashkë me material si konkluzion ku Komiteti për Politikë dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Komunës, ndryshimin e nenit katër të Propozim-rregullores dhe teksti aktual zëvendësohet si në vijim: Të drejtë aplikimi për bursë komunale kanë të gjithë nxënësit e shkollës së mesme të lartë teknike Arkitekt Sinani në Mitrovicë. Nëse ka dikush diçka për diskutim, e hapi për diskutim.

Xhyljeta Imeri: Shkolla teknike krijon kuadrot që gjenden shumë mirë në tregun e punës, ku drejtimet e saj garantojnë punësim të lehtë, pasi janë profesione shumë të rëndësishme në jetën tonë.

Të diplomuarit e shkollës teknike me kualifikime shtesë mund edhe të fillojnë të hapin bizneset kështu që bursat për nxënësit e kësaj shkolle janë shumë të rëndësishme dhe të nevojshme dhe të përpiqemi që zgjedhje e parë për regjistrim të jetë shkolla teknike. Ju uroj që të vazhdoni me bursa dhe t'i motivojë fëmijët që të regjistrohen në këtë shkollë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-Rregullore Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë, sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Rregulloren Për ndarjen e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë.

Pika 3

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Faruk Mujka: Kryesuese që është obligim ligjor, është i përvitshëm, e dimë cili është roli i votimit të kësaj pike, e dimë që asnjë pronë nuk mund të ipet, procedohet pa vendimin adekuat për secilën pronë prej kësaj, mirëpo është problem se nga tridhjetë e pesë asamblistë pak mundemi me e ditë se për cilën pronë po bëhet fjalë, prandaj po e jap si ide që në të ardhmen së paku me një incizim nga ajri e kishim ditë se për cilën parcelë po bëhet fjalë.

Artan Berisha: Kanë qenë vitin e kaluar me ortofoto krejt, sivjet janë vetëm njëzet parcela, ku gjashtë prej tyre planifikohen gjashtëmujorin e parë të ipen, kjo për shkak të ndryshimit të ligjit të ri, andaj do të vijmë të përmirësuara prapë pas gjashtë muajsh, kështu që herën tjetër do të vijmë me ortofoto.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024.

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar me shumicë votash Propozim-vendimin për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listës së veçantë të pronave, të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024, të cilit i bashkëngjitet destinimi nga Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit.

Pika 4

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera.

Rezultati i votimit: 22 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për miratim të participimit të fermerëve në projektet: Subvencionim me mekanizëm bujqësor, Subvencionim me koshere për bletë dhe Subvencionim i fermerëve me sera.

Pika 5

Kryesuesja para se të hap diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani” ky propozim-vendim ka ardhur nga DKRS-ja, e cila i ka propozuar pesë anëtarë të komisionit, ndërsa në KPF kemi propozuar që këtij propozimi t'i shtohen edhe katër anëtarë nga Kuvendi, duke marrë parasysh nga praktika e kaluar dhe kemi vendosur që këto propozime të vijnë dy nga opozita, dy nga pozita dhe një nga partitë e vogla, andaj po vazhdojmë me propozime për komision.

Shkëlqim Ibrahim: Unë e propozoj znj. Nafije Rexha.

Faruk Mujka: Unë e propozoj z. Jeton Zeneli.

Xhyljeta Imeri: Unë e propozoj z. Gazmend Asllani.

Gjergj Beka: Unë e propozoj z. Vesel Neziri.

Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani” me këtë përbërje: Nazmi Rracaj, Sheribane Nuhi, Kemajl Muja, Asllan Vitaku, Riza Preteni, Nafije Rexha, Jeton Zeneli, Gazmend Asllani dhe Vesel Neziri.

Rezultati i votimit: 23 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit “Lah Nimani” me këtë përbërje: Nafije Rexha, Jeton Zeneli, Gazmend Asllani, Vesel Neziri, Nazmi Rracaj, Sheribane Nuhi, Kemajl Muja, Asllan Vitaku dhe Riza Preteni,

Pika 6

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Rekomandimin e Komitetit për Komunitete për zëvendësimin e anëtares së Komitetit znj. Nermina Mulliq Helshani. Bashkangjitur me material e kemi edhe dorëheqjen e zonjës Nermina.

Faruk Mujka: E lexova arsyetimin e saj, ajo tha që nga Kuvendi Komunal nuk janë marrë parasysh shqetësimet e komunitetit boshnjak. Tash, ky komiteti që është për komunitete, ndoshta ish desht me na tregu cilat janë ato shqetësime që s'janë marrë parasysh dhe e dyta, ma merr mendja që më burimore kish me qenë me ardhë një kërkesë apo një propozim prej vetë komunitetit boshnjak, qysh po më doket shumë pa lidhje na me marrë vendim për komunitetin boshnjak.

Kryetari Bedri Hamza: Ke shumë të drejtë, do të thotë e para, kur thotë se nuk janë marrë në konsideratë, duhet mi specifiku çka s'është marrë në konsideratë, që na me ditë, edhe si Asamble, por edhe si ekzekutiv, çka duhet me përmirësua, çka duhet me korigjua. Edhe e dyta, pasi që kjo veç ka dhënë dorëheqje, mendoj që sot na duhet ta aprovojmë dorëheqjen e saj, ndërsa sa i përket kush me qenë anëtar i komitetit prej këtij komunitete, ky komunitet të na sjell vet propozimin për anëtar të Komitetit, sepse ata e din më së miri se kush duhet me i përfaqësua.

Kryesuesja Vesa Broja: Vë në votim miratimin e dorëheqjes së zonjës Nermina, ndërsa propozimin për zëvendësimin e saj e sjellim në seancën e ardhshme pas komunikimit me komunitetin Boshnjak.

Rezultati i votimit: 24 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht dorëheqjen e znj. Nermina Mulliq Helshani nga pozita e anëtares së Komitetit për Komunitete.

Pika 7

Pyetje dhe përgjigje

Armend Begu: Pyetja ime është për Drejtorinë e Infrastrukturës: A është e vërtetë që është dhënë leja në ato hapësira të cilat i ceka më herët, a s'është e vërtetë? Fjala është për rrugën "Pajazit Boletini"?

Granit Tmava: Shqetësimin të cilën ju e ngritët për parkimin e veturave në trotuarin e Rrugës "Pajazit Boletini", ka hapësirë edhe për këmbësorë edhe për parking, ka leje të parkimit për vetura dhe është e ndarë pjesa për këmbësorë dhe pjesa për parkimin e veturave. Ai parking shfrytëzohet për të gjithë banorët e asaj rruge.

Kryetari Bedri Hamza: Kemi nevojë për më shumë sqarime sikurse unë po ashtu edhe asambleja, sa unë arrita me kuptuar po thuhet që gjerësia e asaj sipërfaqe është gjashtë metra trotuar, i cili është i dedikuar për këmbësorë, dhe pjesa tjetër e dedikuar për parking. Mirëpo, pyetja ime është a ka qenë edhe më herët me leje, dhe a ka pasur leje? Nëse ka pasur leje, në mbledhjen e radhës në Kuvend na e prezanton lejen, ai është parking publik, po jo i njëjti me u shndërruar me pengesa dhe me vendosjen e pengesave të caktuara në parking privat.

Granit Tmava: Zotëri Begu, nëse flasim për Rrugën "Pajazit Boletini", komplet trotuari, prej fillimit deri tek Rruga "Shemsi Ahmeti", që del prej rrethit të Gjinnazit, tek Rruga "Shemsi Ahmeti", ana e djathtë, është trotuari i ndarë për këmbësor dhe është pjesa për parkimin e veturave për të gjithë qytetarët që banojnë në atë zonë dhe qytetarët tjerë. Nëse flasim për një zonë tjetër, të lutna tregona dhe nëse është parkim ilegal, atëherë duhet të merret dikush tjetër.

Armend Begu: Rruga prej drejtimit të Gjinnazit në drejtim të "bunarit" domethënë në anën e djathtë të rrugës sa ma brenda dyqaneve është lënë për këmbësor, në pjesën e jashtme të trotuarit janë parkingje, çka unë konsideroj se nuk është në rregull se i kanë vu pengesat aty me dryna, ose është dhënë leja ose i kanë vu ilegalisht. Në anën tjetër, në anën e majtë, tash e kundërta deri te ai parkingu ku hyn te Muzeu bash aty janë vendosur ato të sofistikuarat.

Granit Tmava: Jo zotëri Begu, ana e djathtë për të cilën jeni duke folur ka qenë parking, nuk është bërë sot e as dje, ajo ka qenë tash e disa vite, ndërsa kur jemi duke folur tek ana e majtë, para dy muajve, me inspektoratin ne kemi bërë shenjëzimin e zonës se ku është e lejuar të parkohet, duke mos cenuar aspak hapësirën për qytetarë, por ne me inspeksionin do të dalim të inspektojmë se ku është pengesa, e cila është bërë pengesë për kalimin e qytetarëve dhe do ta eliminojmë atë që është ilegale, siç jemi duke folur për parkimet të cilat bëhen me dry.

Armend Begu: Është diskutuar problemi i parkingjeve aty, nuk ka qenë si pikë e rendit të ditës, inspeksioni unë e di publikisht ka dalë edhe i ka heqë do pengesa aty, unë kam menduar që është duke u vepruar dhe janë duke i liru hapësirat publike të uzurpuara. Mirëpo, tash ato veç janë legalizuar dhe aty nuk ka hapësirë edhe për parking. Nuk është gjendja më e mirë as në Rrugën "Avni Shabani".

Kryetari Bedri Hamza: Unë po kërkoj prej drejtorëve të drejtorive përkatëse, çështjen që e ngriti zoti Begu, për të cilën po diskutojmë, respekt për secilin qytetar të Mitrovicës, po anarki nuk lejohet. Unë po kërkoj prej Drejtorisë së Infrastrukturës, bashkë me Inspeksionin, të zbatohet ligji, nëse duhet asistencë nga organet tjera, ju jeni të detyruar me bë një gjë të tillë. Prandaj, në mbledhjen e radhës të Asamblesë, me ardhë me informatë për Asamblenë pse ka ndërruar gjendja? Kjo nuk lejohet! Me vendosë dryna edhe pengesa në prona publike për qëllime të shfrytëzimit privat, nuk lejohet!

Xhyljeta Imeri: Unë kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit: A keni bërë kërkesë në Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e shkollës "Abdullah Shabani" dhe nëse po, a keni ofruar argumente të mjaftueshme që ndërtimi i kësaj shkolle të jetë prioritet për vitin 2024 nga ministria?

Drita Kadriu: Çështja e shkollës "Abdullah Shabani" është duke u trajtuar këtë vit me prioritet. Ne si Komunë kemi themeluar një komision nga ekspertët, inxhinierët e profileve të ndryshme. Kanë dalë e kanë konstatuar gjendjen e shkollës dhe me të vërtetë duhet me intervenuar me objekt të ri sa më shpejt që mundemi. Ne kemi kontraktuar një numër të konsiderueshëm edhe të deputetëve dhe në

Ministrinë e Arsimit kemi bërë kërkesë. Po të shohim, me buxhetin që është votuar në Kuvend nuk është pjesë e buxhetit, po besoj shumë që ka hapësirë me rishikim në qershor të përfshihet edhe shkolla e “Abdullah Shabani”, kish me qenë shumë mirë për Kuvendin tonë Komunal edhe për qytetarët që në këtë mandat, së paku ta nisim shkollën, është përndryshe edhe premtim elektorale i Kryetarit, ka qenë kërkesë e qytetarëve edhe prindërve palestra sportive, e cila besoj që vitin e ardhshëm fillon, ndërsa nëse aprovohet buxheti edhe nga Qeveria, ka hapësira të mjaftueshme që të punohet në të dyja edhe shkollën mos me ndërpre mësimin. Edhe një informatë tjetër, kemi biseduar me një numër të konsiderueshëm të donatorëve, nuk kemi diçka konkrete nga donatorët, po kemi besim që tema që është hapë edhe kërkesa që po bëjmë do të realizohet.

Kryetari Bedri Hamza: Është një prej shkollave më të rëndësishme në komunën e Mitrovicës, në një objekt me gjendje jo të pranueshme për asnjërin prej neve. E dimë që ajo shkollë është dëmtuar edhe gjatë luftës. Është bërë një improvizim i rinovimit të saj, po nuk është ajo e duhura. E tha drejtoresha, po të jem pak edhe më specifik, unë kam pritë që të kemi mirëkuptimin dhe të kemi një vizitë të një delegacioni shumë të lartë prej Katarit edhe përveç këtyre projekteve të përfunduara në Lagjen Frashër edhe projektit të filluar në ndërtimin e Qendrës të Mjekësisë Familjare në Iliridë, si bashkëfinancim i Komunës me këtë organizatë, me i prezantuar dy projekte, e njëri prej këtyre projekteve ka qenë shkolla “Abdullah Shabani”. Jemi duke punuar edhe me Ministrinë e Arsimit, edhe me të gjithë donatorët e mundshëm, edhe brenda buxhetit, por është objekt i cili do trajtim dhe besoj që në mundësinë e parë, prej cilitdo burim të financimit të jetë mundësia, kjo shkollë do të trajtohet. Është një prej shkollave ndër më të vjetrat edhe me numër të madh nxënësve dhe nuk besoj që për momentin në Mitrovicë ka tash për tash prioritet më të madh se ndërtimi i kësaj shkolle.

Faruk Mujka: Me Drejtoreshën ne kemi pasë kontakte të mëhershme për këtë çështje dhe nëpërmjet kërkesës së Drejtorisë janë kontaktuar deputetët tanë, unë nuk jam i sigurt, por fatkeqësisht po më duket se nuk ka kërkesë zyrtare nga DKA-ja për këtë çështje, po është më shumë në nivelin e debateve, diskutimeve me deputetë edhe me aq sa kam informata, tash jam zënë pak ngushtë për këtë mbledhje, po aq sa di në leximin e dytë bëhet fjalë për katërqind mijë euro për këtë shkollë. Jam kontaktuar se a është në pyetje renovimi apo ndërtimi, kam thënë se nuk vjen në shprehje renovimi, sepse ai objekt nga aspekti konstruktiv është i përmirësueshëm, zgjedhja e vetme është ndërtimi i shkollës dhe ky ndërtim normal kërkon shumë më të madhe të mjeteve financiare. Janë përmendë katërqind mijë euro, tash a ka të bëjë kjo në vazhdimësi, apo vetëm për vitin e parë katërqind mijë €, e pastaj në vazhdimësi të tjerat nuk jam i sigurt, por pasi është në leximin e dytë, atëherë me siguri gjatë këtyre ditëve mundem më saktë me ditë se cili është fati i saj, mirëpo se po flitet edhe po ka një lloj lobimi për këtë shkollë, nga të gjithë deputetët dhe nga i gjithë spektri është e padiskutueshme dhe ka me ardhë deri te një përfundim, që është gjë e mirë për Mitrovicën, sepse është shkolla më e madhe dhe më e rëndësishme e Mitrovicës.

Kryetari Bedri Hamza: Unë po kërkoj prej drejtorisë, pasi që edhe ka komunikim me Ministrinë e Arsimit, sepse një kohë ka punuar aty dhe kurdo që të ketë komunikim dhe, e tha zoti Mujka që mes dy leximeve të Ligjit për Buxhetin për vitin 2024 ka mundësi të propozohen amendamentet. Nëse ka nevojë edhe shkresë zyrtare, pse jo, të përgatitet një shkresë zyrtare prej Komunës së Mitrovicës dhe të drejtohet në Komision për Buxhet dhe Financa në formë të amendamentit. E falënderoj edhe e vlerësoj secilin individ, qoftë deputet, asamblist, drejtorët që mundën me kontribuar në këtë punë për të cilën përfitojnë qytetarët e Mitrovicës, mbi të gjitha përfitojnë zonat. Andaj drejtoreshë po të lutna, komunikoj, dhe nëse ka nevojë me shkuar propozim-amendamenti prej Komunës së Mitrovicës, si kërkesë ne jemi të gatshëm me bërë diçka të tillë dhe besoj edhe shpresoj në vullnetin e të gjithë deputetëve, por posaçërisht deputetëve që vijnë prej Mitrovicës.

Nafije Rexha: Kur bëhet fjalë për Shkollën “Abdullah Shabani”, kjo ka qenë kërkesë e imja që 6 vite, është shkolla në të cilën unë punoj që 30 vite dhe gjendja e saj është e mjerueshme, por pajtohemi plotësisht me Kryetarin, sepse të bëhet një investim në një shkollë, e cila duhet të ndërtohet komplet,

më duket që është edhe shpenzim koti. Kështu që unë si anëtare e këtij Kuvendi, në trajnimin e fundit me OSBE-në, kemi pasur rastin të kemi kontakt me deputetët e nivelit qendror, e kam ngritë si iniciativë që kjo të ngritet edhe në Kuvend të Kosovës, pikërisht ditën e mërkurë e kemi marrë si iniciativë dhe përmes deputetes Ganimete Musliu kjo iniciativë është shty edhe në nivelin qendror që të hyjë si amendament në buxhetin e vitit 2024 dhe kjo është kërkuar pikërisht nga Kryetari i Komisionit Armend Muja dhe nga Arjeta Fejza të cilët vijnë nga ky vend që ta japin kontributin e tyre për qytetarët e vet, shumë besoj që do të hyjë si amendament dhe komuna e Mitrovicës të përfitojë në këtë drejtim.

Sevdaim Uka: Ju drejtohem juve Kryetar për një pyetje, për një çështje të kahmotshme, vendosja e numrave postarë në komunën e Mitrovicës, se me të vërtetë është çështje elementare, po shkojmë në përfundim të vitit 2023 dhe kjo na mungon, komunat tjera e kanë përfunduar këtë çështje, me një kontratë sa më të thjeshtë mundet me u kry, prandaj Kryetar a mundesh me na dhënë një sqarim, kur ka mundësi të kryhet.

Kryetari Bedri Hamza: Faleminderit shumë për pyetje dhe që disa herë me shumë të drejtë e ngritë këtë çështje shumë të rëndësishme për qytetarët e Mitrovicës. Çka unë marrë zotim që koston ka me gjetë mënyrën qysh me akomodim në buxhet të vitit të ardhshëm, se sigurisht që do të kemi një bartje të të hyrave dhe prej tyre mundemi me vendosë projekte të reja. Ndërsa komplet procedurat edhe dizajnimin e projektit unë besoj që drejtori përkatës do t'i drejtoj me juve, pasi që veç keni edhe njohuri se si kanë vepruar komunat tjera edhe i njëjti të zbatohet. Ndërsa, për si kosto, unë e marr edhe përgjegjësinë dhe besoj që kjo do të bartet te drejtoria kompetente, do të jetë besoj Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ajo e cila do ta bëjë zbatimin e këtij projekti.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 12:00 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:



Afërdita MAXHUNI



Kryesuesja e Kuvendit



Vesa BROJA